

ODA E MJEKËVE TË KOSOVËS - SUKSESI I PARË I REFORMËS SË SISTEMIT SHËNDETËSOR



Ferid Agani

Ish-Ministër i Shëndetësisë

Synimi im politik që nga ditët e para të mandatit si Ministër i Shëndetësisë në vitin 2011 ishte që të themelohet njëra prej tri shtyllave kryesore të reformës së sistemit shëndetësor të vendit, shtylla e resurseve mirë të organizuara profesionale njerëzore që do të ishte në gjendje të bartë përgjegjësin e shtuar publike të profesionistëve shëndetësorë në procesin e reformës, si ndaj qytetarëve ashtu edhe ndaj institucioneve relevante vendore e ndërkombëtare. Këtë qëllim e realizuam me sukses nëpërmjet partneritetit bashkëpunues ndërmjet Ministrisë së Shëndetësisë, shoqatave profesionale në lëmit e mjekësisë, stomatologjisë, farmacisë, infermierisë dhe fizioterapisë, organizatave sindikale në këto lëmi, Agjencionin për Zhvillim të Qeverisë së Luksemburgut dhe Federatën e Mjekëve të Republikës Federale të Gjermanisë. Në fund të procesit mjaftë kompleks, që nga njëra anë përfshinte komponentin legjislativ e nga ana tjetër atë organizative dhe menaxherial, me Ligjin për Odat e Profesionistëve shëndetësorë, të miratuar me 4 korrik 2013, u themelua për herë të parë në historinë e shëndetësisë kosovare Oda e Mjekëve të Kosovës, si e para prej pesë odave profesionale. Ky ishte sukcesi i parë i reformës së sapo filluar shëndetësore.

Konsideroj se Oda e Mjekëve të Kosovës i ka përmbushur objektivat e përcaktuara me strategjinë shëndetësore të Kosovës dhe legjislacionin në fuqi. Ajo, në mes të tjerave, nga njëra anë ka mundësuar integrimin organizativ e funksional të mjekëve të Kosovës e nga ana tjetër ka sigurua mekanizma për zhvillimin e tyre të vazhdueshëm profesional. Duke siguruar procese cilësore, mirë të kontrolluara, të regjistrimit dhe licencimit të mjekëve nga njëra anë dhe specializimit e sub-specializimit të tyre nga ana tjetër, Oda e Mjekëve të Kosovës ka përmbushur rolin e saj publik duke avancuar cilësitë profesionale, etike e morale të anëtarëve të saj si dhe duke artikuluar interesat specifike të mjekëve në procesin e reformës shëndetësore dhe proceset relevante shoqërore.

Aktualisht, sfida kryesore me të cilën ballafaqohet Oda e Mjekëve është fuqizimi i rolit të saj në procesin e vazhdimin të reformës së ndër-

prerë shëndetësore në vitin 2015, proces ky i cili i vetmi do të krijon shpresën për avancimin e shpejtë të shëndetësisë kosovare, tejkalimin e vështirësive aktuale dhe përmirësimin substancial të perspektivës profesionale e materiale të mjekëve të Kosovës. Vlerësoj se Oda e Mjekëve duhet të jetë shumë më e zëshme dhe më e vendosur në kërkesat për zbatimin e legjislacionit në fuqi që rregullon dy shtyllat e tjera të reformës shëndetësore, Ligjin për Shëndetësi (shërbimet e mjekësisë familjare dhe Shërbimin Spitalor Klinik Universitar të Kosovës) dhe Ligjin për Sigurime Shëndetësore që rregullon funksionimin e Fondit të Sigurimeve Shëndetësore. Mendoj se ky është interesi jetik i mjekëve dhe detyra prioritare e organizatës së tyre përfaqësuese në këtë kohë të stagnimit serioz të shëndetësisë kosovare.

Oda e Mjekëve duhet të shndërrohet në promotor dhe gjenerator të reformës shëndetësore në vend, rezultat i parë i së cilës edhe ka qenë; është kjo përgjegjësi historike të cilën, jam i bindur, mjekët e Kosovës së bashku me profesionistët në odat e tjera shëndetësore do ta përmbushin me sukses. Oda e Mjekëve të Kosovës, do të mund të realizojë të gjitha potencialet e saja transformuese vetëm në rrethanat e një sistemi të reformuar shëndetësor, prandaj insistimi i saj në vazhdimin e menjëhershëm të reformës së ndërprerë në vitin 2015, nëpërmjet transformimit të SHSKUK në ndërmarrje publike të nivelit qendror dhe funksionalizimit të plotë të Fondit të Sigurimeve Shëndetësore, paraqet imperativ të kohës.

Më ka lënë mbresë të paharrueshme dita kur disa vite pasi që u largova nga posti i Ministrit të Shëndetësisë hyra në hapësirat e Odës si mjekëve për të përmbushë obligimet e mia ligjore të rilicencimit. Ishte kënaqësi e jashtëzakonshme të shih të jetësuar me sukses një vizion tëndin politik. Për këtë, falënderojë përzemërsisht të gjithë bashkëpunëtorët e mi, vendor e ndërkombëtar, udhëheqjet e Odës, e veçanërisht kolegët e mi, mjekët e të gjitha profileve profesionale, që këtë vizion timin politik e përmbushën me sukses të plotë.

Zoti i Madhërishtëm e priftë me të mbara Odën e Mjekëve të Kosovës.



Nënshkrimi i Kodit të Etikës dhe Deontologjisë Mjekësore